



SIKA AT WORK

QENDRA TREGTARE UNIVERS, TIRANË, SHQIPËRI

PËRFORCIM STRUKTUROR: Sistemi SikaWrap® FRP

BUILDING TRUST



QENDRA TREGTARE UNIVERS, TIRANË, SHQIPËRI



PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qendra tregtare Univers (QTU) u hap në vitin 2005 dhe është e para qendër tregtare e ndërtuar në Tiranë. Ndodhet pak minuta larg qendrës së qytetit dhe ka akses të lehtë nëpërmjet autostradës Tiranë-Durrës. Përbëhet nga një hapësirë me dyqane të ndryshme, restorante dhe mjedise për publikun. Kati i ri është një koncept tërësisht i ri i dizajnit të brendshëm, me më shumë dritë natyrore, që i përkushtohet kryesisht argëtimit dhe gastronomisë, siç janë p.sh. 4 sallat e reja të kinemasë me teknologji të lartë, këndë lojërash për fëmijët, lloje të ndryshme kafenesh dhe restorantesh brenda dhe jashtë ndërtesës (veranda). QTU është pjesë e Grupit Balfin, grupi më i madh investimesh inovatore në rajon.



KËRKESAT E PROJEKTIT

U vendos për zgjerimin e funksionalitetit të ndërtesës me një kat të dytë mbi strukturën ekzistuese, duke shtuar kështu 14.000 m² më tepër dhe duke arritur një sipërfaqe totale prej 47.000 m² me një dizajn të brendshëm të ri si dhe shërbime të reja. Buxheti i projektit kishte vlerën 15,000,000 € dhe punimet e përforcimit strukturor përfunduan gjatë vitit 2018. Zgjidhja u vendos nga studioja e projektimit dhe ishte sistemi për përforcim strukturor SikaWrap®, i cili aplikohet përpara nisjes së punimeve për ndërtimin e katit të ri.



ZGJIDHJET NGA SIKA

Duke qënë se struktura ekzistuese do të zgjerohet me një kat të mbi të, ishte i nevojshëm shtimi i kapacitetit për mbartje peshe, ngarkese dhe sforcimi të trarëve dhe kolonave ekzistuese. Në përforcimin e strukturës përfshihej ngjitja e pëlhurës me fibra karboni SikaWrap®-600 mbi nënshtresën e përgatitur prej betoni të trarëve dhe kolonave duke përdorur adezivët epoksidë Sikadur®-300 & -330. Kjo ishte një mënyrë efikase për shtimin e rezistencës ndaj shkarjes/ prerjes dhe kapacitetit për mbartje ngarkese me anë të një aplikimi të shpejtë të materialit.





SASIA E PRODUKTEVE SIKA:

Pëlhura FRP: SikaWrap®-600 C: 5.500 mt
Adezivi-rrëshirë: Sikadur®-300 (Përb. A+B): > 1 ton
 Sikadur®-330 (Përb. A+B): ~ 1 ton

PJESËMARRËSIT NË PROJEKT:

Pronari/ kontraktori kryesor: MANE TCI
 Studio projektimi: AVE Consulting, Prof. Eng. E. Paci
 Nënkontraktor/ aplikues: TEKNOEDIL SHPK



Sika Albania SHPK
 Blv. "Gjergj Fishta",
 Alpas Center, kati i 3-të
 Tiranë, Shqipëri

Kontakt:
 Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com / info@al.sika.com

BUILDING TRUST

